



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 13, datë 11.04.2008

**PËR EMERTIMIN SHESHIT “PAVARESIA E KOSOVES”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim Relacionin “Për emërtimin e një sheshi me emrin Sheshi Bukureshti”, mbështetur në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, (i ndryshuar) neni 8, paragrafi VII, neni 32, gërma “ll”, pika 11, Ligjin Nr. 9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave”, neni 3, me propozim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Tiranës,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë emërtimin e sheshit që krijohet në kryqëzmin e rrugës “Murat Toptani” me rrugën “George W. Bush”, me emrin “Sheshi Pavarësia e Kosovës”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria e Përgjithëshme e Menaxhimit të Shërbimeve dhe Njësia Bashkiake Nr.2
3. Ky vendim, hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**Sokol DERVISHAJ**

**K R Y E T A R**